

**V E N D I M**  
**Nr. 384, datë 20.5.1996**

**PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NË PUNË**  
*(Ndryshuar me VKM nr. 205, datë 9.5.2002; nr. 499, datë 6.5.2009)*  
*(i përditësuar)*

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**A. Të përgjithshme**

1. Kushtet e punës të punëmarrësve nën moshën 18 vjeç, duhet t’u përshtaten moshës së tyre. Punëdhënësi nuk u propozon atyre asnjë punë të një natyre të tillë që mund t’u dëmtojë shëndetin, zhvillimin fizik, psikologjik, moral e social ose t’u kompromentojë edukimin.

2. Punëdhënësi merr masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë dhe të shëndetit të të miturve nën moshën 18 vjeç, duke pasur parasysh veçanërisht rreziqet specifike që rrjedhin nga mungesa e eksperiencës, nga mungesa e të qenit i ndërgjegjshëm për ekzistencën e rreziqeve ekzistuese a të mundshme ose nga zhvillimi i të miturve. Për këtë qëllim punëdhënësi kryen rregullisht vlerësimin e rreziqeve që lidhen me punët që ata kryejnë.

**B. Këshillimi dhe formimi i profesionit**

3. *Të miturit nën moshën 14 vjeç mund të jenë subjekte të formimit profesional, me autorizim të Inspektoratit Shtetëror të Punës.*

Kërkesa për autorizim duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e punëdhënësit ose emrin e ndërmarrjes së tij, adresën e tij, emrin dhe mbiemrin e punëmarrësit, datëlindjen e punëmarrësit, përshkrimin e punës që do të kryhet dhe orarin e punës. Punëdhënësi është i detyruar t’i japë inspektoratit të punës të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme. Autorizimi i inspektoratit të punës nuk është i nevojshëm kur formimi ose stazhi në ndërmarrje janë organizuar nga autoritetet e ngarkuara me edukimin dhe formimin profesional.

**C. Punët e lehta**

4. Të miturit nga mosha 14 deri në 16 vjeç mund të punojnë vetëm gjatë pushimeve shkollore, me kusht që të punësohen në punë të lehta dhe që inspektorati i punës të ketë lëshuar një autorizim për punëdhënësin.

Kërkesa për autorizim duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e punëdhënësit ose emrin e ndërmarrjes së tij, adresën e tij, emrin dhe mbiemrin e punëmarrësit, datëlindjen e punëmarrësit, përshkrimin e punës që do të kryhet dhe orarin e punës. Punëdhënësi është i detyruar t’i japë inspektoratit të punës të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme. Në kuptimin e këtij vendimi me “punë të lehta” kuptojmë çdo punë, e cila, për shkak të natyrës së detyrave që ajo nënkupton për t’u kryer dhe të kushteve të veçanta kur kryhen:

a) nuk dëmtojnë sigurinë, shëndetin a zhvillimin e të miturve dhe

b) nuk pengojnë ndjekjen nga ana e tyre të shkollës, pjesëmarrjen në programet e orientimit a të formimit profesional të miratuar nga autoriteti kompetent apo aftësinë e tyre për të përfituar nga formimi i marrë.

Kohëzgjatja e punës nuk mund të kapërcejë 6 orë në ditë dhe as 30 orë në javë. Të paktën një herë në vit të miturit nga 14 deri në 16 vjeç duhet të kryejnë një periudhë pushimi prej 4 javësh të lirë nga çdo veprimtari shkollor dhe nga çdo lloj pune.

**D. Punët e vështira ose të rrezikshme**

5. Punëdhënësi duhet të njoftojë tek inspektorati i punës punësimin e çdo personi të

moshës 16 deri në 18 vjeç. Njoftimi i punësimit përmban emrin dhe mbiemrin e punëdhënësit a të ndërmarrjes së tij, adresën e punëdhënësit, emrin dhe mbiemrin e punëmarrësit, datëlindjen e tij, përshkrimin e punës që duhet të kryhet dhe orarin e punës. Punëdhënësi është i detyruar t'i japë inspektoratit të punës të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme.

Inspektorati ndalon marrjen në punë të punëmarrësit, kur punësimi:

a) tejkalon objektivisht kapacitetin fizik a psikologjik të punëmarrësve;

b) *nënkupton një ekspozim të dëmshëm ndaj agentëve fizikë, biologjikë dhe kimikë, të përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi;*

c) paraqet rreziqe aksidenti, për të cilat mund të mendohet se të rinjtë, për shkak të mungesës së përvojës a të formimit të duhur, nuk mund t'i identifikojnë ose t'i parandalojnë;

d) vë në rrezik shëndetin, për shkak të temperaturave shumë të ulëta ose shumë të larta a për shkak të zhurmave e dridhjeve të forta.

Inspektorati Shtetëror i Punës kujdeset që lista e agentëve të parashikuar në paragrafin e mësipërm, shkronja "b" e kësaj pike, të jetë vazhdimisht në përputhje me zhvillimin e fundit. Inspektorati shqyrton përmbajtjen e kësaj liste të paktën një herë në vit dhe i bën ministrit të Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish të Përndjekurve Politikë propozimet e mundshme, me qëllim miratimin e tyre në Këshillin e Ministrave.

*Për punëmarrësin nën 18 vjeç, kohëzgjatja ditore e punës është jo më shumë se 6 orë në ditë. Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është të paktën 4 javë.*

E. Veprimtari kulturore, artistike, sportive dhe publicistike.

6. Marrja në punë e të miturve deri në 18 vjeç, me qëllim pjesëmarrje në veprimtari të natyrës kulturore, artistike, sportive a publistike i nënshtrohet një autorizimi paraprak të lëshuar nga inspektorati i punës.

Kërkesa për autorizim përmban emrin dhe mbiemrin e punëdhënësit a të ndërmarrjes së tij, adresën e punëdhënësit, emrin dhe mbiemrin e punëmarrësit, datëlindjen e tij, përshkrimin e punës për t'u kryer dhe orarin e punës.

Punëdhënësi është i detyruar t'i japë inspektoratit të punës të gjitha të dhënat e tjera të nevojshme.

Autorizimi lëshohet sipas kushteve të përcaktuara nga inspektorati i punës dhe vetëm nëse veprimtaritë:

a) nuk janë të një natyre të tillë që t'i shkaktojnë dëm sigurisë, shëndetit a zhvillimit të të miturve, dhe

b) nuk janë të një natyre të tillë që të dëmtojnë frekuentimin nga ana e tyre të shkollës, pjesëmarrjen e tyre në programet e orientimit a formimit profesional, të miratuara nga autoritetet kompetente ose aftësinë e tyre për të përfutur nga kurset e kryera.

G. Pushimi javor.

7. Për çdo periudhë prej 7 ditësh të miturit nën 18 vjeç përfitojnë një periudhë minimale pushim javor prej 2 ditësh pa ndërprerje; pushimi javor përfshin të dielën. Nuk mund të bëhet përjashtim nga ky rregull, veçse për një arsye të justifikueshme dhe të pranuar si e tillë nga inspektorati i punës.

Të paktën 6 herë në vit punëdhënësi mund ta japë këtë pushim javor në 2 ditë jo të njëpasnjëshme, kur kjo gjë diktohet nga arsye teknike ose organizative të justifikueshme.

H. Pushimet

8. Të miturit nën 18 vjeç përfitojnë, në rastin kur kohëzgjatja e punës së ditës kalon 4 orë e gjysmë, një pushim prej të paktën 30 minutash të pandërprerë.

I. Kontrolli mjekësor

9. *Punëmarrësit e mitur, nën 18 vjeç, para fillimit të marrëdhënieve të punës duhet të paraqesin, pranë mjekut të ndërmarrjes, raportin e komisionit mjeko-ligjor, ku të deklarohet aftësia e tyre për punë.*

10. *Punëdhënësi, gjatë marrëdhënieve të punës, duhet t'u garantojë punëmarrësve të*

*mitur kontroll periodik mjekësor për gjendjen e tyre shëndetësore, të përshtatur edhe në funksion të rreziqeve, të cilat lidhen me punë, që ai kryen.*

*11. Kontrolli periodik mjekësor kryhet çdo:*

*a) 12 muaj punë, për punëmarrësit e mitur, nën 18 vjeç, të cilët janë të punësuar në punë të lehta;*

*b) 6 muaj punë, për punëmarrësit e mitur, nën 18 vjeç, të cilët janë të punësuar në punë të vështira, të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

*12. Punëdhënësi përballon shpenzimet për kontrollet periodike mjekësore të punëmarrësit të mitur dhe garanton ruajtjen e kufidencialitetit të çdo të dhëne, lidhur me gjendjen e tij shëndetësore.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

LISTA E PUNËVE TË VËSHTIRA OSE TË RREZIKSHME, ME EKSPOZIM TË  
DËMSHËM NDAJ AGJENTËVE FIZIKË, BIOLOGJIKË DHE KIMIKË PËR TË MITURIT  
NËN 18 VJEÇ

*(Shtuar me VKM nr. 205, datë 9.5.2002)*

Janë punë të vështira ose të rrezikshme, me ekspozim të dëmshëm ndaj agjentëve fizikë, biologjikë dhe kimikë për të miturit nën 18 vjeç, punët e mëposhtme:

1. punët në prodhimin, përpunimin dhe përdorimin e lëndëve shpërthyese, gazrave të djegshme, lëndëve toksike, lëndëve kancerogjene etj;
2. punët gjatë të cilave punëmarrësi ekspozohet ndaj:
  - rrezeve jodizuese, që përmbajnë doza më të larta nga të lejueshme;
  - zhurmave me mbi 85 decibel në punë statike, si dhe zhurmave me mbi 140 decibel, në punët e çastit;
  - temperaturave tepër të larta ose të ulëta, për një farë kohe, si dhe në nxehtësi të lartë rrezatuese;
  - kushteve të këqija atmosferike për kryerjen e punëve urgjente.
3. punët gjatë të cilave punëmarrësi detyrohet të mbajë qëndrim jo të rregullt ose të përdorë pjesë të trupit për një kohë të gjatë në pozicion të detyruar;
4. punët ku përdoren lëndët që çlirojnë dioksid të lirë të piritit ose kripëra të përbëra të piritit dhe të amiantit;
5. punët për prodhimin, përpunimin e ngjyrave me përbërje karboni;
6. punët në përdorimin e tretësve që përbëjnë benzol;
7. në punët për djegien e mbeturinave dhe groposjen e tyre;
8. punët në të cilat prodhohen ngjitësa, si dhe në depot ku bëhet regjia e lëkurëve;
9. në punët ku bëhen kopanisja, shkrifërimi, tjerja e pambukut ose e leshit;
10. punët në shtypshkronjë;
11. punët në prodhimin dhe përpunimin e qelqit, si prerje, lëmim etj;
12. punët në lyerjen me pistoletë, si punë sistematike, si dhe në lyerjen e pjesëve metalike;
13. puna në uzina dhe laboratorë, që prodhojnë dhe përpunojnë:
  - acide;
  - kripëra të klorit;
  - anilinë dhe ngjyrues me anilinë dhe azot;
  - fosfor;
  - plehëra kimike.
14. punët në zbardhjen dhe tretjen e letrës;
15. punët në industrinë metalurgjike;
16. punët në fabrikat e blojës (në repartet ku ka shumë pluhura);
17. puna në uzinat dhe laboratorët ku prodhohen ose përpunohen:
  - lëndët shpërthyese;
  - fishekzjarret;
  - gazet ndriçuese, lëndët ndezëse ose aty ku ngrihen pluhura, që paraqesin rrezik

shpërthimi.

18. punët në bodrume;
19. saldimet, prerjet me oksigjen ose elektricitet, përveçse kur zbatohen programe të formimit profesional;
20. punët ku përdoren makinat lëvizëse;
21. punët ku përdoren vinçat;
22. punët ku përdoren presat hidraulike;
23. punët me makineri, që kanë mjete prerëse, të cilat lëvizin me forcë mekanike dhe veçanërisht:
  - punimet me sharrë hark, sharra kordele, makinat e lëmimit të drurit;
  - punimet me gërshërë në makinë prerëse;
  - punimet në makineritë që punojnë me cilindra dhe që rrezikojnë kapjen e pjesëve të të ndryshme të trupit.
24. në punimet me enët në trysni;
25. punët në pastrimin, riparimin dhe kërkimin e defektit të makinerive dhe të mjeteve në lëvizje;
26. punët për shtypjen e butonave që transmetojnë lëvizje dhe ndal punën e makinerive;
27. punët për mirëmbajtjen e makinerive, të pajisjeve elektrike dhe të ndërtesave;
28. punët për vrojtimin e sigurisë në punë, ndërlidhjen dhe bashkëveprimin e punëtorit, që e kryen një punë me punonjës të tjerë, të cilët kryejnë një punë tjetër;
29. punët në nëntokë;
30. punët në të cilat përdoren makineritë e ndërtimit;
31. punët për shkatërrimin e objekteve të ndërtimit;
32. punët për ndërtimin e kolonave dhe të mureve brenda në ujë, si dhe në shqepjen e kolonave;
33. punët për përdorimin e pajisjeve elektrike të tensionit të lartë; puna në objekte me tension më të lartë se 50 volt;
34. punët nënujore, që kryhen me skafandër apo me aparat frymëmarrjeje;
35. punët për ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve, përveç skafeve të vegjël, që kanë gjatësinë më pak se 12 m dhe gjerësinë më pak se 4 m;
36. punët në vendet me rrezik rënieje, nga lartësia 3 m, edhe sikur të jetë bërë sigurimi me litar shpëtimi ose të jenë marrë masa të tjera;  
Ndalimi nuk ekziston vetëm nëse ka rrethim mbrojtës në çdo vend pune.
37. punët, ku ka rrezik rënieje materialesh në vendin e punës, ku lëviz punëmarrësi;
38. punët me makineritë e shpimit;
39. punët me pistoletë për mbërthim-zbërthimin e vidave dhe bulonave;
40. punët për prerjen e lëndëve drusore me makina elektrike;
41. punimet në degëzimet e linjave të trenave dhe ku punëmarrësi merr pjesë në lidhjen e vagonëve;
42. punët për pastrimin dhe lyerjen me pistoletë me trysni mbi 2.5 atmosferë;
43. punët për fryrjen e gomave të autobusëve, makinave, aeroplanëve me trysni mbi 3 atmosferë;
44. punët si shoqërues në transportin e fondeve monetare për në bankë apo agjenci bankare dhe anasjelltas;
45. punët për kërkime ndaj kancerit dhe sëmundjeve ngjitëse;
46. punët në vendet ku ka mungesë oksigjeni ose ekziston një atmosferë e rrezikshme (lëndë helmuese ose shpërthyes).

